



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 1259/prot.  
4

Tiranë më 10.102018

**VENDIM**

Nr. 53, datë 10.10.2018

**PËR**

**URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi, z. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1259 Prot., datë 06.08.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës së datës 02.07.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm në lidhje me:

- 1. Cila është situata aktuale infrastrukturës së godinave, cilat janë mangësitë në infrastrukturën e godinave dhe ambienteve, mangësitë në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, mungesat aktuale të pajisjeve dhe mjeteve diagnostikuese e kuruese spitalore;*
- 2. Mungesat aktuale të medikamenteve dhe mungesat aktuale të mjekëve dhe infermierëve, ku të specifikohen arsyt e këtyre mangësive për të gjitha institucionet e mëposhtme:*
  - Klinikës së Shërbimeve Shëndetësore Qeveritare;*
  - Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë;*
  - Spitalit Universitar të Traumës Tiranë;*
  - Spitalit Universitar OBS-GJIN "Mbretëresha Geraldinë"*
  - Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi";*

- Spitalit Universitar OBS-GJIN "Koço Gliozheni";
- Spitali Psikiatrik Vlorë, Shkodër, Elbasan;
- Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim;
- Klinikës Stomatologjike Universitare Tiranë;
- Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter
- Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- Oficinës Elektro Mjekësore;
- Qendrës Kombëtare të Cilësisë;
- Spitalit Rajonal të Durrësit;
- Spitalit Rajonal të Elbasanit;
- Spitalit Rajonal të Shkodrës;
- Spitalit Rajonal të Lezhës;
- Spitalit Rajonal të Fierit;
- Spitalit Rajonal të Kukësit;
- Spitalit Rajonal të Korçës;
- Spitalit Rajonal të Beratit;
- Spitalit Rajonal të Vlorës;
- Spitalit Rajonal të Gjirokastrës;
- Spitalit Rajonal të Dibrës;
- Gjithë spitalëve bashkiakë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me sa kërkon në kërkesën e sipërcituar z. \_\_\_\_\_, pretendon se nuk ka marrë përgjigje nga ana e Autoritetit Publik dhe për këtë arsye ka bërë ankesë pranë Zyrës së Komisionerit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me shkresën nr. 1264/1 Prot., datë 07.08.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik rivlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 14.08.2018. Detyrimi për informim nuk rezultoi i përmbushur, megjithëse ka kaluar afati i vendosur nga Komisioneri.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka vijuar ankimin me nr. 1259/1 Prot., datë 20.09.2018 pranë Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, me Urdhrin Nr.243, datë 08.10.2018, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e z. \_\_\_\_\_ është depozituar pranë Autoritetit Publik nëpërmjet shërbimit postar, vërtetuar kjo nga receta postare nr. 9301 datë 02.07.2018 dhe është regjistruar me nr. H- 57 Prot., datë 04.07.2018. Nga verifikimi i kryer nga koordinatori në regjistrin e protokollit të institucionit rezultoi se kërkesa e Z. \_\_\_\_\_ i ka kaluar për trajtim njëhënës prej strukturave pranë këtij autoriteti, dhe për këtë

kërkesë koordinatori sqaroi se nuk është vënë në dijeni. Gjithashtu, rezultoi se Autoriteti Publik nuk ka proceduar me kthim përgjigje për kërkuuesin.

Bazuar në nenin 15 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Autoriteti Publik, trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Për sa më sipër, konstatohet se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin për të informuar kërkuuesin.

Nga shqyrtimi i çështjes rezulton se informacioni i kërkuar nga z. \_\_\_\_\_ përmbush kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Ligji për të Drejtën e Informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Si rrjedhojë, duke qenë se informacioni që kërkohet është informacion publik atëherë dhe dhënia e tij është një detyrim ligjor që do të përmbushi kërkesën për informim dhe do të rrisë ndjeshëm transparencën.

Për sa më sipër, nga ana e Autoritetit Publik duhet të procedohet me vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankimin e z. \_\_\_\_\_ ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 1259/1 Prot., datë 20.09.2018 të z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik "Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 02.07.2018: 1. Cila është situata aktuale infrastrukturës së godinave, cilat janë mangësitë në infrastrukturën e godinave dhe ambienteve, mangësitë në infrastrukturën e pajisjeve spitalore, mungesat aktuale të pajisjeve dhe mjeteve diagnostikuese e kuruese spitalore; 2. Mungesat aktuale të medikamenteve dhe mungesat aktuale të mjekëve dhe infermierëve, ku të specifikohen arsyet e këtyre mangësive për të gjitha institucionet e mëposhtme:

- Klinikës së Shërbimeve Shëndetësore Qeveritare;
- Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë;
- Spitalit Universitar të traumës Tiranë;
- Spitalit Universitar OBS-GJIN "Mbretëresha Geraldinë"
- Spitalit Universitar "Shefqet Ndroqi";
- Spitalit Universitar OBS-GJIN "Koço Gliozheni";
- Spitalet Psikiatrik Vlorë, Shkodër, Elbasan;
- Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim;
- Klinikës Stomatologjike Universitare Tiranë;
- Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopter
- Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore;
- Oficinës Elektro Mjekësore;
- Qendrës Kombëtare të Cilësisë;
- Spitalit Rajonal të Durrësit;
- Spitalit Rajonal të Elbasanit;
- Spitalit Rajonal të Shkodrës;
- Spitalit Rajonal të Lezhës;
- Spitalit Rajonal të Fierit;
- Spitalit Rajonal të Kukësit;
- Spitalit Rajonal të Korçës;
- Spitalit Rajonal të Beratit;
- Spitalit Rajonal të Vlorës;
- Spitalit Rajonal të Gjirokastrës;
- Spitalit Rajonal të Dibrës;
- Gjithë spitaleve bashkiake në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda datës 17.10.2018.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 10.10.2018.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

